

Doloreza Petrela Rrapollari

E' dua

Vajza që thotë gjithmonë “Pse?”



Ilustrimet nga Gea Qendro

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN: 9789928960610

© AUTORJA dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

I dedikohet mbesës time.

E' duas, vajzës së vogël që më kujton çdo ditë që bota është plot me pyetje dhe mrekulli. Ajo që me "pse-të" e saj, më frymëzoi të shkruaj këtë libër.

Ty, lexues i vogël, të uroj që kureshtja të të çojë drejt zbulimeve të bukura! Nga pyetjet e tua zbulohen mrekullitë e botës.

Dhe unë duke dëgjuar "pse-të" e saj më lind natyrshëm pyetja: Pse është kaq e bukur bota feminare?

Sepse është e pastër. E kjo përgjigje më vjen nga Ajer, motra e E' duas që më jep çdo ditë kënaqësinë për të kuptuar se çdo të thotë të duash dhe të të duan.

Uroj që kureshtja jote E' dua ime të të çojë drejt zbulimeve të bukura në jetë!





Na ishte njëherë një vajzë e bukur me emrin E'dua.

Dhe si në çdo përrallë që nis me fjalët “Na ishte njëherë” edhe unë kam dëshirë të njiheni me botën e E'duas si në një përrallë të vërtetë, sepse E'dua është një vajzë përrallash.

E bukur, e mençur, lozonjare, por pak trazovaçe dhe çapkëne...

Ka dy sy të ëmbël, një gojë të vogël dhe buzët me ngjyrë qershie.

Ajo ka dy sy kureshtarë por plot me dritë. Shikon gjithçka rreth saj me shumë habi.

Sa herë që shikon diçka të re ajo ndalon për një çast, mendon pak dhe bën pyetjen e saj të preferuar: “pse”, dhe në çdo “pse” të saj fshihet një sekret i vogël i botës.

Një vajze e vogël me një pyetje të madhe.

Ajer motra e madhe shpeshherë mërzitet nga pyetjet e saj, por E'dua nuk dorëzohet. Vazhdon të pyesë vazhdimisht dhe me këmbëngulje kërkon përgjigjet madje edhe me argumente.

Dhe sa herë që ajo pyet bota është e gatshme të tregojë sekretet e saj.

Jam e bindur që këto sekrete të botës janë edhe në pse-të tuaja të dashur vogëlushë.

E'dua dhe mëngjesi i saj

E'dua zgjohet nga gjumi dhe me një zë të ëmbël thotë:
Mirëmëngjes.

Dy sytë ë saj plot dritë të japin jetë.

Ajo është vetëm 5 vjeç.

Zgjohet e bindur se do bëhet gati, shkon të lajë syçkat e bukura, fytyrën engjëllore dhe nuk harron asnjëherë dhëmbët e saj qumështore. Ajo shkon në parashkollor...

Dita zgjohet bashkë me buzëqeshjen e saj.

Mami duke i krehur flokët e artë i shpjegon:

- Kujdesi ndaj dhëmbëve është shumë i rëndësishëm. Nëse nuk i lan çdo ditë ato prishen dhe duhet të shkosh te dentisti.

- Po pse vetëm kur prishen dhëmbët duhet të shkojmë te dentisti?

Mami buzëqesh lehtë.


- Jo ke shumë të drejtë që pyet, sepse te dentisti duhet të shkojmë për kontroll shpeshherë, jo vetëm kur kemi probleme.

- Po si quhet ndryshe dentisti?

- Ndryshe quhet stomatolog.

E'dua tashmë gati për në shkollë, në të cilën shkon me shumë dëshirë buzëqesh lehtë dhe thotë e lumtur:

- E mësova dhe diçka të re.



E'dua në një ditë me shi

Sot E'dua u zgjua pak me vështirësi. Nga dritarja nuk pa diellin, i dukej ende errësirë. Nuk po e kuptonte pse. Megjithatë u bë gati për në shkollë. Kur doli jashtë pa që binte shi. Në çadrën e saj pikat e shiut krijonin një melodi të ëmbël.

Sapo hyri në klasë përshëndeti shokët dhe mësuesen.

- Mirëmëngjesi mësuese. A mund të pyes për diçka?

- Po, patjetër - i tha mësuesja me shumë dashuri.

- Pse bie shi?

Mësuesja buzëqeshi lehtë.

- Po unë të të bëj një pyetje ty E'dua.

- Po mësuese.

- Kur mami të bën çaj në mëngjes çfarë vë re ti në kapakun e çajnikut?

- Disa pika uji që bien prapë poshtë.

- E pra e njëjta gjë ndodh me shiun. Nga nxehtësia avujt e ujit ngjiten lart në qiell te retë. Kur retë mbushen shumë nuk e mbajnë dot ujin dhe ai bie poshtë në formën e pikave të shiut.

- Uaaaa sa e thjeshtë! Kur të shkoj në shtëpi do shikoj shiun e çajit tim.

Përgjigjja E'duas krijoi të qeshura.

